



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

Të mbledhjes së pestë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb), i mbajtur më 02.11.2022.

Z. Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, e hapi mbledhjen e pestë të Komitetit, duke i përshëndetur të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës u mbajt në udhëheqjen e nënkryetarit Zogaj. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues komunalë, përfaqësues të këshillave të bashkësive, përfaqësues të komuniteteve, përfaqësues të grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës etj.

Njëzëri u miratua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Informatë mbi punën e Këshillave Lokale të Sigurisë Publike në Prishtinë (KLSP);
4. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimi publik;
5. Raporti i përfaqësuesit të IOM për dy punëtorë;
6. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të KKSb-së.

Njëzëri u miratua ekstrakti i mbledhjes së katërt të KKSb-së.

**Pika e dytë**

Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës.

Fjala iu jepet komandantëve të stacioneve të policisë në komunën e Prishtinës.

Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni policor "Veriu" në Prishtinë, është bërë analizimi i raportit mujor të muajit tetor, 2022, krahasuar me muajin tetor të vitit 2021. Kemi rritje të lehtë të rasteve tek kapitulli i veprave penale kundër pasurisë, është shënuar rritje të veprat penale mashtrim, dëmtim dhe vjedhje në tentativë. Ulje të numrit kemi të vjedhjet në përgjithësi, detyrimet dhe falsifikimet e parave.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit, rritje kanë shënuar rastet e kanosjeve, ndërsa vetëm për këta dy muajt e fundit kemi zbritje të veprave penale – dhunë në familje dhe të sulmeve.

Veprat penale të armëve kanë shënuar rritje, ngjatë vitit 2021 kemi pasur 5 raste, gjatë këtij viti, 2022, kemi 19 raste. Aksidentet e trafikut gjithashtu kanë shënuar rënie dhe gjobat e shqiptuara kanë shënuar ngritje. Rol të rëndësishëm tek aksidentet e trafikut, që muajve paraprak kemi pasur ngritje të numrit të aksidenteve në trafik, kanë ndikuar shumë vendosja e pengesave në rrugën “Vëllezërit Fazliu”. Në këtë kontekst kisha paraqitur kërkesë, që pengesa të vendosen në rrugën “Bajram Bahtiri” dhe “Justina Shkupi”. Gjatë muajit tetor kemi mbajtur ligjërata, ku kanë marrë pjesë 280 nxënës. Temat për të cilat janë mbajtur ligjërata kanë qenë “Bullizmi dhe masat parandaluese”, si dhe “Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik”. Për muajin nëntor kemi planifikuar të vazhdojmë me ligjërata, ku temë e ligjërimit do të jetë “Parandalimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm”.

**Bekim Zogiani, kapiten, zv. komandant i Stacionit policor “Jugu” në Prishtinë,** theksoi se gjendjen e sigurisë e kemi të qetë dhe stabile. Gjatë këtij viti, krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rënie të numrit të rasteve në 15.8%. Sa i përket rasteve të aksidenteve në trafik, kemi një rënie prej 36.7%, në përgjithësi, duke u bazuar në Planin operativ për ofrimin e sigurisë në shkolla, ju njoftojmë se kemi pasur disa raste incidente, kryesisht në shkolla të mesme, të cilat janë trajtuar me Prokurorinë.

**Zekeria Jonuzi, toger, shef i Sektorit të operativës, Stacioni policor “Qendra” në Prishtinë,** sa i përket gjendjes së sigurisë, theksoi se ajo është e qetë dhe e qëndrueshme. Stacioni policor “Qendra”, gjatë muajit të kaluar, ka pas aktivitete të shumta operacionale, gjë që ka angazhuar një numër të madh të personelit. Jemi përkrahur nga stacionet tjera, por mbi të gjitha çështja e sigurisë nuk ka mbetur anash. Situata e sigurisë në trafik pothuajse është e njëjtë, mirëpo policia ka pasur aktivitete të shtuara, duke shqiptuar një numër të madh të gjobave për lirim të hapësirave publike, që në këtë rast falënderojmë Drejtorinë e Inspeksionit për bashkëpunim.

Sa i përket sigurisë në shkolla, deri tani jemi të kënaqur. Kemi dy zyrtarë policor të angazhuar në planin operativ të sigurisë në shkolla, ku janë në kontakt të vazhdueshëm me DKA-në dhe drejtorët e shkollave. Jemi duke vazhduar me ligjëratat nëpër shkolla, gjithçka është duke shkuar në rregull.

Zbatimi i planit operativ për prishjen e rendit dhe qetësisë publike, ne si staf komandues e kemi mbikëqyrë direkt zbatimin e këtij plani, inspektorët komunalë kanë asistuar në të gjitha rastet, me ç’rast i falënderojmë shumë.

### **Pika e tretë**

#### **Informatë mbi punën e Këshillave Lokalë të Sigurisë Publike në Prishtinë (KLSP)**

**Violeta Hasani, zona “Qendër” në Prishtinë,** i falënderoi Stacionin policor “Qendra” dhe Komunën e Prishtinës për bashkëpunimin e ndërsjellë me KLSP-në.

Ajo bëri të ditur se “Prishtina Parking”, ka filluar me i gjobitur banorët rezidentë, për çka ka edhe pakënaqësi, e të cilët janë të gatshëm edhe të bëjnë protesta. Unë kam biseduar me banorët dhe iu kam premtuar që do të zgjidhet ky problem në bashkëpunim me Komunën.

KLSP “Qendra” takimet me qytetarë i ka të rregullta, më datën 10 kemi caktuar një takim me banorë, andaj ju ftoj që të merrni pjesë dikush nga Komuna e Prishtinës. Ne këtë takim do të këtë qytetarë të shumtë që do të marrin pjesë. Po ashtu, ne si KLSP kemi donacione në vazhdimësi që u shërbejnë qytetarëve të bashkësisë.

**Hetem Kupina, kryesues i KLSP-së Bernicë, me seli në Bardhosh,** theksoi se KLSP në Bardhosh, zona e përgjegjësisë ka 19 fshatra, rreth 30.000 banorë, ka qytetarë të komuniteteve të ndryshme jo shumicë, 6 Bashkësi Lokale, 5 shkolla amë dhe një shkollë në gjuhën serbe, një shkollë fillore, një shkollë e mesme dhe një kolegji universitar privat. Ka 6 xhami, 3 kisha, disa ndërmarrje prodhuese, disa ferma të kafshëve dhe shpezëve, dy qendra për strehimin e qenve endacakë.

KLSP jone përveç 12 takimeve të rregullta që i mban çdo muaj, më së paku edhe tri herë në vit bëjmë takim me përfaqësuesit. Bazuar në të dhënat e marra nga këta përfaqësues, si konkluzion është ky: Se gjendja e sigurisë është e shkëlqyer fal vetëdijes së lartë të qytetarëve, punës së shkëlqyer të policisë asnjë eksens ndëretnik, ndërnjerëzor dhe ndërfqinjësor.

**Dragan Bojkovic, falënderohet për zgjidhjen e problemit të ndriçimit në Bardhosh.**

Kohen e fundit kanë pasur disa probleme shumetnike tek fëmijët dhe me këtë rast ata e kanë paraqitur në Bashkësinë Lokale në Bardhosh, aty kanë gjetur përkrahje, këta kanë kërkuar rritjen e numrit të

policisë në këtë pjesë ku e kanë marrë ndihmën. Problemi tjetër është në Bërnice të Poshtme, ku një kohë të gjatë kanë probleme me ujërat e zeza, herë pas here zgjidhet problemi për një kohë të shkurtër, por nuk është i zgjidhur përfundimisht. Me këtë rast kërkon rindërtimin në një pjesë ku kërkohet. Në fund kërkon zgjidhjen e problemit me qentë endacakë.

**Betim Abdullahu, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim**, tha se sa i përket projekteve të investimeve kapitale dhe shërbimeve publike, anëtarët e Komitetit për Komuniteteve e dinë që ne e kemi një buxhet të dedikuar dhe të gjitha kërkesat që kanë ardhur prej përfaqësuesit të komunitetit serb, janë proceduar në drejtoritë përkatëse.

**Safija Hyseni, KLSP "Dodona"**, theksoi se i kemi 4 shkolla filllore dhe një shkolle të mesme, së bashku me policen e lagjes, e kemi bërë një plan, ku deri në fund të vitit kemi me i vizituar të gjitha lagjet që i përfshinë kjo KLSP të Matiçanit, të Sofalisë dhe të Parkut të Qytetit.

Problemet zakonisht kanë qenë me ndriçim, tash vone është bërë një ndryshim tek Parku i Qytetit, ku janë zhvendosur kontejnerët dhe rruga vazhdimisht është duke u mbushur me mbeturina, trotuari është duke u punuar, andaj kishim kërkuar nga ju që të na lajmëroni për ndryshime dhe punimet në lagje, që ne të kemi informata të sakta me i informuar qytetarët. E dyta, e kam potencuar në takime të shumta për gjetjen e hapësirës, ku mundemi me përdorur për takimet me qytetarët. **Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike**, theksoi se te Parku kemi filluar disa intervenime, ku ka pasur ankesa nga qytetarët për parkingun e paligjshëm në trotualet afër parkut. Në bashkëpunim me kryetarin, është zgjedhur një prej mostrave sa i përket edhe kualitetit, estetikës, është pjesa e skajores, do të jetë më e lartë, por që një shirit gjithashtu është vendosur me u bërë parking, sepse është paraparë që ajo rrugë të jetë njekahore. Me këtë rast i kemi dhënë zgjidhje të dyjave do të ketë edhe trotuar, edhe parking. Do të vendosim edhe ndriçim të posaçëm shtesë, do të ketë intervenime brenda parkut, për dinamikën e punës mendojmë se deri në fund të vitit me përfunduar e gjitha.

Si administrate e re kur kemi ardhur, e kemi gjetur një planifikim të lokacioneve të kontejnerëve, të cilin e ka punuar GIZ-i, në bashkëpunim me Komunën. E vërteta, ne kemi marrë disa ankesa sa i përket lokacioneve, e në disa prej tyre kërkesat kanë qenë me të drejtë, si rasti i Parkut, ose hyrja e QKUK-së, ne po i rivendosim diku tjetër, tek pjesa e Parkut në momentin që e kemi bërë rilokimin, me qëllim që qytetarët me e bërë shërbimin. Ju kisha lutur që t'i njoftoni qytetarët, tash kontejnerët janë në anën e kundërt.

**Hilmi Halili, KLSB-Kalabria**, bëri të ditur se në lagjen "Kalabria" kemi vështirësi të mëdha në qarkullim të lirë, ndriçimi është i kufizuar, investime nuk ka pasur tash e një kohë të gjatë kabëzat në rrugën "Sylejman Vuçitërna", aty është një katrahurë e pakalueshme. Sa i përket pjesës mbi kolektor, aty është pastruar në tremujorin e parë, prapë kanë filluar me hedhur mbeturina. Do të duhej ta kishim një zgjidhje afatgjate, deri pas shkollës me bere një kycje të re me zhavorr, sepse është rrugë e ngushtë ku po rrezikohen nxënësit të shkolla "7 Marsi". Rruga "Dëshmorët e Konushefcit", ka mbet kontest me ujësjellësin, andaj ju kisha lutur që ta bëni një zgjidhje sa më shpejt. Tek Qendra e Mjekësisë Familjare, lodrat e fëmijëve që dy vjet nuk funksionojnë, andaj kish qenë mirë me i larguar prej aty dhe me i vendosur te shkolla, aty është një hapësirë e mirë për kënd lodrash për fëmijët.

**Ilirik Musliu, drejtor**, për rastin e Kalabrisë i kemi pasur tri vizita, kërkesat dhe nevojat që janë shtruar ndërlidhen me disa prej drejtorive e jo vetëm me DSHP, për këtë arsye është vendosur që për Kalabrinë me u bërë një projekt i veçantë. Intervenimet që duhet me u bërë nuk është e lehtë, për shkak të sfidave që i kemi në këtë lagje, siç e cekët edhe ju, rrugët e ngushta, pa plan, pa projektim, duhet bërë të gjitha nga zero. Ideja është që me intervenuar njëherë dhe me bërë zgjidhje të përhershme.

Pasi e përfaqësoni lagjen "Kalabria" ne si drejtori në gjysmëvjetorin e parë nga 22 deponi, 3 deponi i kemi larguar. Ne e kemi bllokuar rrugën, kemi menduar me bërë rivitalizim të hapësirës, që mos me u përsëritur prapë deponitë. Nëse kishit mundur me u takuar me qytetarët me diskutuar, nëse e shihni që po vijnë prej njerëzve të tjerë me na njoftuar.

**Hilmi Halili**, rruga "Regjep Krasniqi", ku kalon lumi Prishtevka, aty është një ngushticë ku është ndërtuar një urë e vogël, gypat janë me të ngushtë sesa është dashtë me qenë, nëse ka mundësi para vjeshtës, kur fillojnë edhe shirat e vjeshtës, kish qenë mirë me pastruar aty.

**Dragan Bojkovic** në Bërnice të Poshtme, tha se në dalje të fshatit, nga fshati Mazgit, ka hedhje të

mbeturinave të egra, qytetarët kanë vetëdijesim të ulët. Nëse ka mundësi Komuna me i siguruar kontejnerët më të mëdhenj që të mos hidhen në mënyrë të parregullt mbeturinat.

**Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni policor "Veriu" në Prishtinë,** paraqiti kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e kemi një deponi të mbeturinave mbrapa Tregut të kafshëve, që ne si polici i kemi gjetur keqbërësit duke hedhur mbeturina, e kemi njoftuar Komunën e Prishtinës, mirëpo përgjigja ka qene se nuk është në menaxhimin e tyre, arsyeja ka qenë se është në menaxhimin e AKP-se. Ju kisha lutur, kush është përgjegjës për atë pjesë, që me i ndëshkuar keqbërësit?

**Ilirik Musliu, drejtor,** bëri të ditur se përgjegjës për gjoba janë Drejtoria e Inspeksionit, ndërsa sa i përket menaxhimit, ashtu e kemi trashëguar ne, ka qene në administrim dhe menaxhim të AKP-së, problemi ka qenë se ata kanë pasur ngecje në kontratën me ndërmarrjen "Pastrimi" që me e menaxhuar atë pjesë. "Pastrimi" në koordinim me AKP-në dhe Shoqatën e Tregut, janë përgjegjës për mirëmbajtjen e asaj hapësire, është kontratë me kushte të veçanta, nuk ka te beje me Komunën. Nëse ka ankesa, atëherë duhet drejtuar tek ndërmarrja "Pastrimi", ndërsa për gjoba është Drejtoria e Inspeksionit.

**Hilmi Halili** tha se mbeturinat tek Tregu me shumice është pastruar, por aty janë bizneset dhe po mbushet shume shpejt, nëse ka mundësi çdo dy ditë me u pastruar, se njëherë në javë është shumë pak.

**Safet Kamberaj, KLSP "Dardania",** si kryetar i Bashkësisë lokale "Dardania", kërkoi të rishikohet mundësia për përmisimin e Planit zhvillimor urbanistik. Aty është katrahurë, ka probleme nëpër rrugë me ndriçim, me shikuar mundësinë e ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Emshir".

Të rishikohet pllatoja e "Kurritzit", pasi që ne banorët e Dardanisë e shikojmë si plan në gjysmë prej vitit 2014. Është mirë që ka me pasur intervenime në tunel, kishte qenë mirë edhe në plato të ketë intervenime, sepse aty dyqanet janë shkatërruar, ku është prishur izolimi, çdo reshje atmosferike aty sjell probleme. Një kërkesë tjetër është që të shikohet mundësia që rruga e cila shkon në drejtim të Termokosit, nga Rrethi i flamurtari, të mundësohet një rrugë aty që të ketë dalje, mund të shfrytëzohet një rrugë që mos te shkojmë deri tek Posta e të kthehemi prapë te rrethi.

Te shkolla "Xhemail Mustafa" ka uzurpime, aty është edhe një motel afër shkollës, kërkujmë me shikuar a i lejohet atij moteli ligjërisht të ushtroj veprimtarinë afër shkollës, me vije ajrore 5m.

Te hapet rruga mes bibliotekës "Hivzi Sylejmani" dhe shkollës "Xhemail Mustafa".

**Ilmi Uka, KLSP Keqekollë,** i përfshinë 8 fshatra, tre bashkësi lokale, aty bëjnë pjese 8 shkolla fillore. Ne mbledhjet tona konsistojnë gjithmonë në përcaktimin dhe diskutimin e çështjes së sigurisë. Mbledhjet tona mbahen më rrallë me kërkesën e anëtarëve të KLSP-së, por kjo nuk do te thotë se siguria nuk është në nivel. Pajtohem me atë që e përcaktojnë policia e Stacionit "Veriu" dhe problemet i trajtojmë bashkërisht. Disa rrugë lokale nuk janë ndërtuar tash e sa vite, tani kanë filluar, andaj ju falënderoj, sepse qytetarët atje kanë pasur shumë vështirësi.

Pakënaqësia nga popullata ka. Në Prapashticë ka filluar ndërtimi i një përmendoreje për dëshmorët e vitit 1921, aty punimet janë ndërprerë, duam të dimë se kur do të përfundojë ky ndërtim.

**Alban Zogaj, kryesues,** theksoi se është e vërtet që shumë kontrata për shkak të ngritjes së çmimeve janë ndërprerë, por do t'i ritenderojmë shumë prej tyre.

**Hetem Kupina,** pasi që u adresuan sfidat, kërkesë e qytetareve identifikimi i pronave të uzurpuara komunale, gjegjësisht pronave publike. Ka nevojë për çerdhe fëmijësh, për qendra kulturore e të tjera. Nën dy, mundësisht lumenjtë Llapi dhe Bernica, është marrë vendim që ujërat e zeza nuk kanë të drejtë me u derdhur në lumenj, nuk është ndërmarrë asgjë për këtë dhe vazhdojnë të derdhen.

Urgjentisht të bëhet identifikimi dhe përcaktimi i kufijve të varrezave të ashkalinjeve në fshatin Besi. Të bëhet vendosja e shenjave në ambulancën e Bardhoshit, sepse parkohen veturat ditëve të premtë dhe iu vështirësohet kalimi pacientëve dhe punëtorëve shëndetësorë, të vendosen shenjat që iu ndalohet parkingu të gjithëve, përveç stafit shëndetësor.

Po ashtu, para zyrës se Bashkësisë Lokale dhe nënstationit policor të vendosen shenjat.

Një familje në Milevc ia ka ofruar një familjes tjetër kashtën e madhe, ka rrezik që dikush me ia vënë flakën. Inspeksioni është lajmëruar, por nuk është marrë me atë çështje.

Komuna e Prishtinës ende nuk e ka të miratuar Planin strategjik, ju lutem që ta punoni sa më shpejt me këtë proces. Kërkesat që i drejtojmë në drejtoritë e Komunës së Prishtinës, të na i kthejnë përgjigjet.

**Alban Zogaj, kryesues,** theksoi se drejtoritë në përgjithësi kanë numër shumë të madh të kërkesave, ne jemi duke u munduar që me angazhuar asistentë, me u angazhuar me kërkesat, me pasur një sistem, ku të gjithë të jemi të kënaqur. Po kalojmë tek pika e peste dhe po e përfundojmë raportimin nga përfaqësuesi i organizatën IOM, pastaj kthehemi tek pika e katërt.

#### **Pika e peste**

##### **Raporti i përfaqësuesit të IOM për dy punëtorë**

**Z. Fushtica,** tha se këto dy punëtorë kanë qenë në shërbim të dëgjimit dhe të sfidave që qytetarët dhe anëtarët e këshillit komunal i kanë identifikuar.

Rendi dhe siguria publike janë shtylla bazike për të garantuar sigurinë publike, janë sundimi i rendit dhe i ligjit, qeverisja e mirë dhe një bashkëpunim që qytetarët duhet ta kenë me institucionet e nivelit komunal dhe me agjencitë e zbatimit të ligjit.

Me duhet të theksoj se e kam parë një angazhim të veçantë tek Institucionet Lokale të Komunës së Prishtinës, të cilët kanë qenë të gatshëm që t'i dëgjojnë sfidat dhe brengat që i kanë përfaqësuesit e KLSP-ve, të cilët janë zëri i drejtpërdrejtë i qytetareve. Ne i kemi organizuar dy punëtorë, njëra më 17.06.2022 dhe e tjetra më 06.10.2022, ku kemi bërë një përmbledhje të të gjitha sfidave, kërkesave e të gjithë qytetarëve që i kanë pasur me rendin dhe sigurinë në qytet. I kemi kategorizuar në katër shtylla kryesore:

Shtylla e parë - siguria në bashkësi;

Shtylla e dytë, siguria në trafik;

Shtylla e tretë - mbrojtja e ambientit;

Shtylla e katërt -siguria në shkolla.

Pika e tretë ka marrë një rëndësi të veçantë, mbrojtja e ambientit ka filluar të zë një vend të rëndësishëm në vetëdijen e qytetareve për mbrojtjen e ambientit, duke e ndërlidhur ngushtë dhe në mënyrë direkte në bashkësinë dhe sigurinë publike. Do t'i ceku disa prej brengave që i kemi identifikuar. është ngritur çështja e rritjes së përdorimit të narkotikëve, në veçanti tek të rinjtë, siguria në trafik, kujdes të shtuar ndaj krimit kibernetik, armët ilegale, qentë endacakë, në të cilin zotëri Gecaj ka informuar Këshillin Komunal për çështjen se deri ku ka mbërritur zgjidhja e këtij problemi, radikalizmi dhe ekstremizmi, degradimi i ambientit nga rreziqet dhe zjarret, dhuna në baza gjinore, mungesa e ndriçimit, shenjeshimi horizontal dhe vertikal, ridizajnimi i rrugëve, nevoja e vendosjeve së kamerave, respektimi i orarit të punës së lokaleve, zhurma e lokaleve, nevoja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me lëmshëkërkuesit, uniformat, rrethojat dhe kamerat në shkolla, mbrojtja në punë, organizimi i projekteve të përbashkëta të KLSP-ve, menaxhimi i mbeturinave inerte, rreziqet në shtëpitë e braktisura dhe ato nën mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, identifikimi dhe menaxhimi i infrastrukturës kritike, materialet piroteknike të magazinuara tek Tregu me shumicë, bodrumet e mbyllura tek banesat kolektive, rrezikshmëria nga rënia e fasadave dhe objekteve tjera të objektet e larta, menaxhimi dhe shtrimi i strehimoreve në rast të emergjencave, përgatitjet dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore, identifikimi i prostitucionit, identifikimi dhe eliminimi i drurëve të rrezikshëm, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të informimit në rast rreziku. Këto janë pikat që janë cekur dhe identifikuar nga anëtarët e Këshillit Komunal në Siguri dhe Bashkësi, i kemi diskutuar dhe i kemi trajtuar gjatë punëtorëve.

Mbesim të hapur për bashkëpunim dhe të zhvillojmë projekte të tjera.

**Dorjeta Rukiqi,** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, shtroi pyetje për përfaqësuesin e IOM, se për çfarë lloji të radikalizmit dhe ekstremizmit po bëhet fjalë, për fetar apo për ndonjë tjetër? .

Organizata jonë studimet që po i bën dy vitet e fundit, kanë rezultuar që ka rritje të radikalizmit etnopolitik dhe etnonacional në të gjithë vendin. Po besoj mbase po flasim për këshill komunal këtu në Prishtinë, ja vlen me vënë një theks të veçantë edhe në këtë drejtim kur ti bëjnë aktivitetet në shkolla.

**Z. Fushtica, përfaqësuesi i IOM-it,** tha se në asnjë mënyrë nuk e kemi përmendur vetëm ekstremizmin fetar. Sipas studimeve që i kemi bërë edhe ne, kemi një rritje të potencuar në shtetet e Ballkanit Perëndimor të radikalizmit të djathtë ekstrem me bazë nacionaliste. Ne si organizatë ndërkombëtare IOM, i mbështesim institucionet e zbatimit të ligjit, në këtë rast Ministrinë e Punëve të Brendshme në

ri integrim, rehabilitim dhe në parandalim të këtij fenomeni. Për më shumë, edhe MPB është në fazën përfundimtare të hartimit dhe miratimit të strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit dhe terrorizmit, ku kemi qenë edhe pjesë e grupit punues për hartimin e këtij dokumenti dhe aty ceken të gjitha format.

**Violeta Hasani KLSP "Qendra",** e falënderoj z. Fushtica, duke thënë se është e vërtetë që zona "Qendër" ka pasur problem me ndotjen akustike, me ardhjen e re të qeverisjes lokale vërehet një ndryshim i madh, kemi ndryshime pozitive në të gjitha aspektet.

**Hetem Kupina,** u shpreh se e kam lexuar të tërën çka është diskutuar aty dhe në shenjë respekti dëshiroj t'i falënderoj që na kanë sjellë shumë njohuri neve përfaqësuesve të KLSP-ve, për çka mund të mësojmë edhe në të ardhmen në aspektin e sigurisë.

#### **Pika e katërt**

**Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimi publik.**

**Ilirik Musliu, drejtor,** për ndriçimin Publik bëri të ditur se është arritur kontrata me u nënshkruar, e cila i ka 7 lote, 4 lote janë në qytet, njëra është për parqe, parkingje edhe dy lote përfshijnë zonën rurale, fjala është për mirëmbajtje të ndriçimit publik ekzistues. Për zgjerimin e ndriçimit jemi duke pritur, për arsye se kontrata është në OSHP. Në momentin që marrim përgjigje, ku me këtë kontratë i kemi paraparë 4 lote, duhet intervenuar në disa prej zonave ku ka nevojë. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve për sezonin e dimrit, i kemi 11 lote, 7 për zonën qytet dhe 4 për zonën rurale. Jemi në kohë për me i bërë intervenimet me kohë edhe në mirëmbajtje të rrugëve dhe trotuareve.

**Ilmi Uka, KLSP Bardhosh,** tha se nga përvoja ime e hidhur tri vitet e kaluara, nëse vendosni me i mirëmbajtur të gjitha rrugët, atëherë mirëmbajini të gjitha e jo diku po e diku jo. Ju lutem, regjistroni të gjitha familjet që janë të banuara, që të mos iu mohohet e drejta elementare.

**Sevdije Ramadani, përfaqësuese e komunitetit Goran,** tha se për trafikatin e sheshi "Edi Durham" Komuna na ka premtuar për ndriçim, kish qenë mirë me intervenuar shpejt, sepse tani pasi që është ndërruar ora, nuk mundemi me punuar më gjatë se ora katër, por edhe me iu vendosur nga një strehë për mbrojtje nga shiu, sepse kur ka reshje shiu uji po futet brenda.

**Ilirik Musliu,** bëri të ditur se drejtorja ka bërë disa intervenime, me qëllim që të jetë sa më shumë funksionale. Këtë lloj kërkesash nuk e kemi pasur, por do të bisedoj me Ndërmarrjen Publike Banesore çka mundemi me bërë dhe me intervenuar.

**Hetem Kupina,** tha që ta përdorni autoritetin tuaj dhe ta përcillni në ndërmarrjen "Pastrimi" që të caktoj kohën kur e bën grumbullimin e mbeturinave, të ketë një orar të caktuar, sepse nuk kanë orar dhe po kemi probleme.

#### **Pika e gjashtë**

##### **Të ndryshme**

**Mirsada Behluli,** informoi se më 25.10.2022, kemi pasur Komitetin për Komunitete, ku të gjitha komunitetet jo shumicë kanë deklaruar se situata e sigurisë është stabile dhe nuk kane asnjë problem. Nga 13.09.2022 e deri më 18.09.2022, kemi organizuar vizita në shkollat e Komunës së Prishtinës për të gjitha komunitetet jo shumicë, ku kemi konstatuar se arsimin e ndjekin 287 nxënës dhe sa i përket situatës së sigurisë, në atë periudhë nuk është lajmëruar asnjë rast që ka ndonjë problem.

**Betim Abdullahu,** duke u ndërlidhur me vizitat në shkollat, tha se ato mbahen së bashku me Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim, po pasi që janë policia këtu dhe janë duke mbajtur trajnime për edukime, po ju informoj se në shkollën fillore "Emin Duraku", janë 7 fëmijë të ardhur nga vatrata e luftës, kryesisht nga Siria. Po ashtu kërkesë e shkollës ka qenë të kenë psikolog për shkak të gjendjes së fëmijëve.

tha se për informata detale e kemi informuar Drejtorinë e Arsimit, për të gjitha problemet rreth mësimin dhe nevojat e shkollës të cilat i kanë dhe informatën rreth nxënësve të Sirisë dhe Irakut, i kemi të gjitha informatat.

**Melihate Sefedini, kapitene,** tha se desha t'ju njoftoj se i kemi të gjitha informatat edhe për shkollën "Emin Duraku" dhe "Nazim Gafurri", të gjitha ligjëratat të cilat i kemi planifikuar i bëjmë në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës dhe Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës. Në rast se ka kërkesa shtesë, ne jemi të gatshëm në çdo moment me mbajtur ligjëratat aty ku ka nevojë.

**Z. Fushtica, IOM,** sa i përket fëmijëve të kthyer nga zonat e luftës, MPB në bashkëpunim me ne dhe me institucionet tjera, ka zhvilluar një program të ri integritit dhe rehabilitimit të gjithë fëmijët para se të kthehen në procesin e rregullt mësimor, kanë pasur proces të veçantë të mësimit, duke pasur edhe mbështetjen e psikologut dhe sociologut. Ka fëmijë edhe ne shkollat "Meto Bajraktari" e "Nazim Gafurri", kemi intervenuar dhe kemi caktuar një klasë të veçantë në shkollën "Emin Duraku", e kemi një projekt të veçantë, po ashtu edhe në shkollën "Qemal Mustafa" dhe në shkollën "Meto Bajraktari" jemi në zhvillim të dy projekteve për këtë kategori të veçantë të fëmijëve. Mirëpo kjo kategori e veçantë e fëmijëve është në përkujdes të divizionit për parandalim dhe riintegrim të MPB-së, të cilët punojnë ngushtë me Policinë e Kosovës, Departamentin e Terrorizimit në ndihmën dhe përkrahjen e riintegritit sa më të mirë të këtyre fëmijëve.

**Premtime Preniqi, koordinatore e Njesisë për të drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore në Komunën e Prishtinës,** tha se pasi u diskutua lidhur me ligjëratat nëpër shkolla, prej tetorit deri në nëntor, 1 muaj aktivizëm kundër trafikimit me qenie njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit i kemi filluar këto fushata, mirëpo çka kemi hasur, mënyra e organizimit kish qenë më mire jo ligjëratat, sepse fëmijët janë më të lodhur prej ligjëratave, mirëpo ne e kemi marrë si iniciativë fëmijët vetë të ligjërojnë, vet mbajnë aktivitete të artit, edhe në shumë shkolla kemi organizuar edhe në mënyrë aktrimi, me kuptuar se si munden me rënë pre e trafikantëve të ndryshëm. Me këtë desha të them se mirë do të ishte me ndërruar mënyrën e të mbajturit ligjëratat, sepse fëmijët po janë me të vëmendshëm dhe po përfshihet e gjithë shkolla.

**Procesmbajtësja**  
**Edona Krasniqi**

**Kryetari i Komunës**

**Përparim Rama**

